



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr.168, Datë 02.11.2020

**“MBI
KËRKESËN PËR RISHIKIMIN VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 146, DATË
10.09.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË SEKA HYDROPOWER SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET
“SEKË” ME KAPACITET TË INSTALUAR 12667 KW DHE “ZAIS”, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2295 KW, ME KAPACITET TOTAL TË
INSTALUAR 14962 KW”.**

Në mbështetje të nenit 16 pika 5, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 92 të “Kodit të procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 16, pikat 1, 2 dhe 3 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 02.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.116/8 prot, datë 02.10.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi rishikimin vendimit të bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë Seka Hydropower shpk., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrik,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 146, datë 10.09.2020, vendosi: 1. Të licencojë shoqërinë “Seka Hydropower” shpk., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Sekë”; me kapacitet të instaluar 12667 kW dhe “Zais” me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total 14962 kW, për një afat 28 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1140 prot, datë 01.10.2020, është paraqitur nga përfaqësuesja me prokurë të posacme znj. Dorina Ndreka, e komunitetit të zonës ku po zhvillohet projekti i HEC-ve Sekë dhe Zais, kërkesa për rishikimin e tij.
- Gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë, rrethanave e fakteve të paraqitura në të, me emailin e datës 22.10.2020, protokolluar në ERE me nr. 1134 prot., datë 22.10.2020, administratori i shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., ka kërkuar që të njihet me këtë kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 146/2020, me qëllim që të mundësohet dhe dërgimi i informacionit të nevojshëm nga ana e shoqërisë.

- Në vijim, me shkresën nr. 1134/3, datë 30.10.2020, ERE i ka dërguar shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., dokumentacionin shoqëruar mbi të cilin kërkuesi ka mbështetur kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 146/2020, për t’u njohur dhe i ka kërkuar që brenda 3 ditësh të depozitojë në ERE çdo informacion apo dokumentacion që shoqëria beson se mund të argumentojë një qëndrim për të pretenduar rrëzimin e kërkesës së kërkuesit, nëse e disponon.
- Me qëllim marrjen e informacionit nga i licencuari, si dhe nga institucionet kompetente në lidhje me statusin e zonës ku po ndërtohen HEC-et “Sekë” dhe “Zais”, në zbatim dhe të nenit 92 të Kodit të procedurave administrative, që ka prashikuar mundësinë e zgjatjes së afatit të një procedure për sa kohë është e nevojshme, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar, ERE ka të drejtë të zgjasë afatet për shqyrtimin e kësaj kërkesë për rishikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes së Bordit për shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e Vendimit të bordit të ERE nr. 146, datë 10.09.2020.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI